

Përdorimi i
Ndërmjetësimit për të
trajtuar rastet e
ngacmimit seksual në
vendin e punës

Dr. Angela du Plessis

Pikat kryesore të prezantimit

1. Konteksti

- Arena e Ngacmimit Seksual
- Arena e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve

Pikat kryesore të Prezantimit

2. Ndërmjetësimi si qasje premtuese në rastet e ngacmimit seksual
 - Përparësitë e përgjithshme
 - Dy modele

Pikat kryesore të Prezantimit

3. Dobësitë e Ndërmjetësimit
4. Një analizë kritike e Ndërmjetësimit

The background features a watercolor-style pattern. It consists of overlapping, semi-transparent circles in various shades of blue and teal. Superimposed on these circles are delicate, golden-brown branches that resemble coral or seaweed, with thin, tapering limbs. The overall aesthetic is soft and organic.

1.

KONTEKSTI

Arena e Ngacmimit Seksual

Arena e ngacmimit seksual: katër tematikat

Emocional

Kompleks

Përçarës

Shqetësues

Përshkrim i shkurtër i ngacmimit seksual

Sjellje e padëshiruar/e pamiratur e një natyre seksuale

Përkufizim i ngacmimit seksual

Ngacimi seksual përfshin sjelljet e mëposhtme:

- Prekje, dhunë seksuale, përdhunim
- Insinuata, sugjerime, nënkuptime, shaka të natyrës seksuale
- Pyetje pa vend në lidhje me jetën intime të një personi
- Ekspozim i fotografive dhe objekteve me natyrë qartësisht seksuale
- Quid Pro Quo
- Favorizim seksual

Problematikat që vijnë nga vazhdimësia e një sjelljeje të caktuar

- Test subjektiv dhe objektiv
- Minimizimi apo nënvlerësimi
- Synimi kundrejt impaktit

Sfidat

- Mbyllja e gojës së viktimës
- Konfidencialiteti
- Trajtimi i pasojave
- Konkurenca mes të drejtave të Viktimës dhe të Akuzuarit
- Skenari i dëshmitarit të vetëm

The background features a watercolor-style pattern. It consists of overlapping, semi-transparent circles in various shades of blue and teal. Superimposed on these circles are delicate, golden-brown branches that resemble coral or seaweed, with thin, tapering limbs. The overall aesthetic is soft and organic.

1.

KONTEKSTI

Arena e Zgjidhjes Alternative të
Mosmarrëveshjes

Kufizimet e Shqyrtimeve Gjyqësore ose Procesit Formal Gjyqësor

- Vonesat/dosjet e prapambetura
- Kosto shumë të larta
- Rregullat e rrepta për marrjen e provave
- Natyra konfliktuale – Fitues dhe Humbës

Arbitrazhi

- Mund të ketë natyrë konfliktuale ose hetuese
- Palët mund ta zgjedhin Arbitrin
- Kosto të reduktuara
- Zgjidhje e shpejtë

Ndërmjetësimi

Një proces ku një palë e tretë e paanshme i ndihmon pjesëmarrësit të arrijnë në një zgjidhje të mosmarrëveshjes së tyre.

- Disa parime
 - Vullnetar
 - Konfidencial
 - Pa paragjykim
 - Zgjidhja vjen nga vetë palët

Drejtësia Restauruese

- Nisi si një formë Ndërmjetësimi në kontekstin penal
- Viktima dhe Autori përballen më njeri-tjetrin për të riparuar padrejtësinë
- Autorët: e pranojnë dëmin e shkaktuar dhe kuptojnë potencialin e tyre për rehabilitim
- Viktimat: Përfitime terapeutike duke marrë përgjegje për pyetjet e ngritura dhe duke përfituar ndjesën



2.

Ndërmjetësimit si Qasje
Premtuese në Çështjet e
Ngacmimit Seksual

Përparësitë e përgjithshme

Përparësitë e përgjithshme (1/2)

- Fleksibiliteti – p.sh. Koha e përzgjedhur, Diplomaci Vajtje-Ardhje, Sesionet e veçanta
- Fokusi tek e Ardhmja, krahasuar me cili e ka fajin / cili ka çështjen më të fortë
- I shpejtë dhe diskret
- Mund të rivendoset marrëdhënia
- E mbron punëdhënësin nga përgjegjshmëria
- Viktima mbrohet nga trauma sekondare

Përparësitë e përgjithshme (2/2)

- Zgjidhje të posaçme unikale për palët
- I nxit palët që të japin/përshkruajnë versionin e tyre në menyrë të plotë
- Rezultat fitore/fitore kundrejt fitues/humbës
- Autorët e kuptojnë edhe më mirë impaktin e sjelljes së tyre – një proces me natyrë konfliktuale mund të çojë në një situatë ku pala e akuzuar mund të mohojë apo minimizojë impaktin e sjelljes së vet.

“

“Ta marrësh seriozisht ngacmimin seksual nuk do të thotë ta trajtosh atë në rrugë zyrtare por në mënyrë efikase.”

David
Whincup



2.

Premtimi i
Ndërmjetësimit në
Çështjet e Ngacmimit
Seksual

Dy Modele

Dy Modele të Ndërmjetësimit për Ndërhyrje në Çështje të Ngacmimit Seksual (Whittenburg)

Modeli i Procesit
me katër faza

Modeli i zgjidhjes
me konsultim

Dy Modele të Ndërmjetësimit për Ndërhyrje në Çështje të Ngacmimit Seksual (ëhittenburg)

Modeli i Procesit me katër faza

Synimet/qëllimet

- Palët kuptojnë këndvështrimin e njera-tjetrës.
- Zhgënjimi shpaloset në mënyrë pozitive.
- Pikëpamjet e tyre vërtetohen.
- Ato arrijnë vetë tek zgjidhja e mosmarrëveshjes

Modeli me Katër Faza

1

Deklaratat e hapjes nga të dyja palët për t'ua treguar historitë e tyre drejtpërdrejt ndërmjetësit.

Ndërmjetësi evidenton interesat dhe shqetësimet që secila palë kërkon t'u gjejë zgjidhje përmes procesit të ndërmjetësimit.

Modeli me Katër Faza

2

Palët vendosen përballë njera-tjetrës për të kuptuar këndvështrimin e palës tjetër.

Gjatë 2 fazave të para, ndërmjetësi apo palët mund të kërkojnë të kalojnë në sesione të veçanta për të dalë nga një situatë e bllokuar apo për të marrë informacion të fshehtë.

Modeli me Katër Faza

3

U vjen në ndihmë palëve që të njohin perceptimin e palës tjetër, pavarësisht se nuk bien dakord me të.

Modeli me Katër Faza: Zgjidhja

Ndërmjetësi:

4

- U mundëson palëve të dalin me sugjerimet e veta
- I ndihmon palët të jenë të fokusuar dhe të bëjnë testimin e realitetit të sugjerimeve që ato sjellin.
- Lehtëson rrahjen e mendimeve

Modeli me Katër Faza

Kur mund të përdoret ky Model:

- Problemi është i korigjueshëm
- Personi i ngacmuar thjesht dëshiron të ndalojë sjelljen
- Nuk ka qëllime egoiste apo dashakeqe
- Sjellja mund të korigjohet
- Autori i ngacmimit seksual nuk e mohon sjelljen e vet.

Modeli me Katër Faza

Kur nuk mund të përdoret ky Model:

- Quid pro Quo
- Sjellja është fizikisht e rëndë
- Sjellja është e motivuar dashakeqësisht

Nëse ky është rasti, punëdhënësi duhet të ndëmarrë veprime të menjëhershme për t'i dhënë fund sjelljes në fjalë, pavarësisht dëshirave të punëmarrësit raportues.

Dy Modele të Ndërmjetësimit për Ndërhyrje në Çështje të Ngacmimit Seksual (ëhittenburg)

Synimet/qëllimet

- Për të arritur një marrëveshje e cila do t'i mbajë palët jashtë gjykatës
- Ndërmjetësi e negocion zgjidhjen mes palëve

**Modeli i Zgjidhjes
me Konsultim**

Modeli i Zgjidhjes me Konsultim

Takimi para-ndërmjetësimi me të gjitha palët gjatë së cilit ndërmjetësi:

- Hapi 1
- Prezanton veten dhe shpjegon procesin e ndërmjetësimi
 - Kërkon përmbledhje me shkrim të mosmarrëveshjes në fjale, dhe t'i paraqitet çdo dokument tjetër me rëndësi.

Modeli i Zgjidhjes me Konsultim

Sesioni i parë i ndërmjetësimit

- Hapi 2
- Secila palë jep deklarata me gojë në lidhje me pikëpamjet e veta mbi mosmarrëveshjen në fjale dhe prezanton kështu çështjen.


Modeli i Zgjidhjes me Konsultim

- Hapi 3 Ndërmjetësi takohet me palët veç e veç për të mbledhur prova konfidenciale dhe për të prezantuar argumentet ligjore.
- Hapi 4 Ndërmjetësi i zhvillon dhe ua prezanton propozimet për zgjidhje palëve, dhe më pas ndërmerr diplomacinë vajtje-ardhje.

Modeli i Zgjidhjes me Konsultim

Kur mund të përdoret Modeli i Zgjidhjes me Konsultim:

- Sjellja nuk është e kthyeshme por është e përmbajtur
- Palët janë të polarizuara e për këtë arsye diskutimi ballë për ballë bëhet i pamundur.
- Palët ende mund t'i shmangin shpenzimet/shqetësimet dhe ekspozimin publik.
- Marrëveshjet mes palëve mund të jenë kontraktuale dhe detyruese.

The background features a repeating pattern of overlapping, semi-transparent blue circles of various shades, ranging from light sky blue to deep navy. Superimposed on this are golden-brown, stylized branches that resemble coral or seaweed, with thin, tapering limbs and small, pointed tips. The overall aesthetic is organic and textured.

3. Kufizimet e Ndërmjetësimit

Kufizimet e Ndërmjetësimit (1/3)


- Ndjesa nuk është zgjidhja për të gjithë dëmin e shkaktuar nga ngacmimi seksual.
- Pushteti apo karizma e një kundravajtësi mund të sjellë një marrëveshje e cila mund të mos jetë në avantazh të viktimës apo shoqërisë në përgjithësi.
- Nëse përfundon para kohe, mund të përkthehet në kohë, burime dhe energji emocionale të shpenzuara kot.
- Natyra “jo paragjykuese” e ndërmjetësimit mund të kompromentohet.
- A është e vërtetë që shumica e paditësve thjesht dëshirojnë t’i japin fund sjelljes dhe të mos “ndëshkojnë” palën e akuzuar?

Kufizimet e Ndërmjetësimit(2/3)

- Është më efikas nëse ngacmimi është një çështje keqkomunikimi, dallimet në stil dhe pritshmëri kulturore (sjellje e “ulët”), kundrejt abuzim pushteti.
- Ndërmjetësimi mund të jetë më pak efikas nëse viktimi detyrohet të heshtë dhe/ose i frikësohet mosbesimit apo zvogëlimit të rëndësisë së ankesës që ka bërë.
- A është realist konfidencialiteti?
- Ndërmjetësit i kërkohet të jetë mjaft i aftë dhe me eksperiencë në çështjen në fjalë.
- Ndërmjetësimi kërkon vullnet të mirë dhe mirëbesim – jo gjithmonë e mundur.

Kufizimet e Ndërmjetësimit(3/3)

- Ndërmjetësimi u kërkon palëve të spostohen nga pozitat e tyre në lidhje me nevojat dhe interesat.
- Natyra “vullnetare” e ndërmjetësimit: a mund të binden palët?
- Nuk rekomandohet nëse ngacmimi seksual ka ndodhur në formën e dëmit apo sulmit fizik.
- Jo efikas, nëse punëdhënësi ka vendosur ta lirojë të akuzuarin nga akuzat.

The background features a repeating pattern of overlapping, semi-transparent blue circles of various shades, ranging from a deep navy to a lighter teal. Superimposed on this pattern are golden-brown, stylized branches that resemble coral or seaweed, with multiple thin, tapering limbs extending from thicker stems. The overall aesthetic is organic and textured.

4.
Një analizë kritike e
ndërmjetësimit

Një analizë kritike e Ndërmjetësimit

Bazuar në artikullin e mëposhtëm:

- Hippensteele, Susan “Ideologjia e Ndërmjetësimit: Lundrimi nëpër Hapësirën nga Miti tek Realiteti në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve mbi Ngacmimin Seksual” Revista Shkencore e Universitetit Amerikan për Çështje Ligjore, Gjinore dhe të Politikave Sociale, 15, nr.1 (2006): 43 - 68

Një analizë kritike e Ndërmjetësimit

Parakushti bazë që parashtron ajo është se Ndërmjetësimi është një formë detyruese e pajtimit si dhe një mekanizëm për t'i bërë çështjet publike shqetësime private.

Ajo trajton 5 Tema Zgjidhjeje të ngërthyera në Ndërmjetësim për të cilin mendon se “promovon trillin e zbutur se ngacmimi seksual është një ofendim personal, intim ndaj punëtoreve e punonjëseve dhe jo një diskriminim i urryer.”.

Një analizë kritike e Ndërmjetësimit

- Ngacmimi Seksual është një problem unikal “sensitiv” që kërkon vëmendjen e duhur ndaj aspekteve emocionale të situatës.
- Ajo argumenton se ndërsa ndërmjetësimi ka për qëllim shfaqjen e emocioneve, në fakt vlerat gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit dhe pajtimit frenojnë brendinë emocionale të përvojës së ngacmimit seksual.

1

Një analizë kritike e Ndërmjetësimit

2

- Viktimat e Ngacmimit Seksual dëshirojnë/kanë nevojë të ruajnë privacinë e tyre dhe të shmangin stresin që shoqëron proceset e një natyre konfliktuale dhe zyrtare.
- Kjo vazhdon të mbajë në jetë mitin se ngacmimi seksual e nxjerr viktimën në një dritë të keqe.
- Viktima nuk ka mundësi të shfajësohet për sa kohë që personi që tregon të vërtetën është i parëndësishëm për rezultatin e ndërmjetësimit.

Një analizë kritike e Ndërmjetësimit

3

- Viktimat e Ngacmimit Seksual dëshirojnë/kanë nevojë të përballen personalisht me abuzuesin e tyre.
- Kjo nuk është e vërtetë për sa kohë që pjesa më e madhe e viktimave nuk janë në pozita të barabarta negocimi, veçanërisht nëse ka dallime në pozita apo nëse është ushtruar presion.
- Përballja me abuzuesin mund ta ekspozojë viktimën ndaj manipulimeve apo abuzimeve të mëtejshme.

Një analizë kritike e Ndërmjetësimit

4

- Gjykimi Zyrtar i Ankesave i vendos në disavantazh viktimat e ngacmimit seksual.
- Ajo argumenton të kundërtën: nëse dikush ndjek rrugën zyrtare, parime të qarta ligjore mund ta ndihmojnë viktimën që ta përcaktojë dëmin e shkaktuar në kontekstin ku mbrojtja e të drejtave është legjitime.

Një analizë kritike e Ndërmjetësimit

5

- Ngacmimi seksual është një fenomen në thelb subjektiv dhe i paqartë.
- Krimet seksuale është e vëtmja fushë e kriminalitetit ku ne e gjukojmë shkeljen jo nga kundravajtësi por nga viktima.
- Kjo mund ta minimizojë impaktin subjektiv mbi viktimat të cilat janë më së shumti gra të cilat mund të stereotipizohen si emotive dhe që priren ta ekzagjerojnë apo ta teprojnë, ndryshe nga burrat të cilët cilësohen si “racionalë”.

Një analizë kritike e Ndërmjetësimit

Disa Mendimet Përmbyllëse nga Hippensteele

- Ndërmjetësimi mund ta zbusë më shumë se sa ta korigjojë dëmin e shkaktuar nga ngacmimi seksual.
- Grave u flitet se si të kërkojnë strategji marrëdhëniesh jo-konfliktuale për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre.
- Ndërmjetësimi mund të shihet si një proces që në mënyrë efikase shkëmben drejtësinë me harmoninë.



Faleminderit!